



RREGULLORE Nr.1/2014

PËR THEMËLIMIN DHË FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT, PUNËS SË KOMISIONIT, MJEKËVE DHE INXHINERVË NË TRAJTIMIN E DEMEVE

Në bazë të nenit 16, të statutit të Byrosë Kosovare të Sigurimeve, Këshilli Administrativ Byrosë miraton këtë:

RREGULLORE

PËR THEMELIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT, PUNËS SE KOMISIONIT, MJEKËVE DHE INXHINERVË NE TRAJTIMIN E DËMEVË

Neni 1 Qëllimi

Kjo rregullore ka për qëllim përcaktimin e rregullave, rregullimin e procedurës, themelimin dhe funksionimin e punës së komisionit, mjekëve dhe inxhinervë gjatë trajtimit të dëmeve në BKS -, mënyrën e udhëheqjes së punëve, marrjes së vendimeve, mandatin e komisionit etj.

Neni 2 Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë Rregullorë kanë këtë kuptim:

- 1.1. **BKS** - nënkupton Byron Kosovare të Sigurimit,
- 1.2. **Komision** - nënkupton organet e brendshme (trajtuës profesionale) që merren me trajtimin dhe vlerësimin e dëmeve që rrjedhin nga një policë sigurimi.
- 1.3. **Mjeku i Siguruesit (censor)** - nënkupton personin e kualifikuar i cili është i kontraktuar nga siguruesi për kryerjen e shërbimeve profesionale gjatë procedurave të trajtimit të dëmeve në persona.
- 1.4. **Inxhinier** - nënkupton personin e kualifikuar i cili është i punësuar te siguruesi për kryerjen e shërbimeve profesionale gjatë procedurave të trajtimit të dëmeve.
- 1.5. **Ekspert** - nënkupton personat, institutet profesionale të specializuara për llogaritjen e dëmeve në fusha të ndryshme.
- 1.6. **Referent** - nënkupton personin e punësuar si referentit për pranimin e lëndëve, dhe regjistrimin e lëndëve në program të dëmeve.

Neni 3 Themelimi i komisioneve

1. Në kuadër të BKS për punën në trajtimin e dëmeve themelohen dy komisione:

- 1.1. komisioni i shkallës së parë dhe
- 1.2. komisioni i shkallës së dytë-ankesave.

2. Komisionet themelohen me vendim nga Drejtori ekzekutiv në kohëzgjatje prej 4 vitesh me mundësi rizgjedhje në bazë të propozimit të drejtorit të departamentit të dëmeve.

Neni 4

Përbërja dhe funksionimi i komisionit i shkallës së parë

1. Komisioni i shkallës së parë për trajtimin e dëmeve përbëhet nga pesë anëtar.
2. Në përbërje të komisionit të shkallës së parë duhet të jenë tre jurist dhe dy inxhinier të cilët kanë për detyrë ta bëjnë trajtimin dhe vlerësimin e dëmit si për nga baza juridike po ashtu edhe lartësia e dëmit.
3. Puna e komisionit të shkallës së parë për trajtimin e dëmeve fillon në orën 9:00 deri në orën 16:00. Fillimin e punës në komision e bënë kryetari i komisionit, i cili ju përcjell ftesën paraprake për takim anëtareve tjerë të komisionit.
4. Komisioni i shkallës së parë seancat i mban së paku dy herë në javë. Si ditë e punës në komision janë ditët e Martë dhe e Enjte, në rastet kur ka shtim-vëllim të madhe të punëve në trajtim të lendeve atëherë komisioni me kërkesë të kryetarit mund të mbledhet edhe në ditët e tjera të punës.
5. Në rast të pamundësisë të mbajtjes së mbledhjes të komisionit për shkaqe objektive, atëherë kryetari i komisionit njofton anëtarët për shtyrjen e takimit.
6. Në rastet kur kryetari i komisionit nuk është prezent, kryesimin e komisionit mund të merre një anëtar i komisionit të cilin kryetari e cakton paraprakisht.
7. Komisioni i shkallës së parë me shumicën e votave të anëtareve të komisionit jep bazën juridike dhe përcakton lartësinë e dëmit për rastet konkrete që janë parashtruar nga të dëmtuarit respektivisht të autorizuarit e të dëmtuarve.
8. Vendimi i Komisionit të shkallës së parë konsiderohet se është miratuar apo refuzuar kur vendimi nënshkruhet me 2/3 e anëtareve të komisionit.
9. Vendimi i Komisionit të shkallës së parë i nënshkruar nga anëtarët e komisionit duhet të protokollohet nga zyrtari për protokoll dhe i njëjti vendim pas protokollimit dhe regjistrimit i dërgohet palës me shkrim me anë të postës ose emailit nga zyrtari përkatës.
10. Pas miratimit apo refuzimit të kërkesës për kompensim nga komisioni i parë pala e dëmtuar/i autorizuar ka të drejtë të ushtroj ankesë kundër Vendimit të komisionit të shkallës së parë.
11. Ankesa me shkrim i drejtohet komisionit të shkallës së dytë.

Neni 5

Përbërja dhe funksionimi i komisionit i shkallës së dytë-ankesave

1. Komisioni i shkallës së dytë përbëhet nga tre anëtarë në përbërje të të cilit duhet të jenë dy jurist dhe një inxhinier.
2. Seancat në komisionin e shkallës së dytë për trajtimin e dëmeve i cakton kryetari i komisionit i cili njofton me ftesë paraprakisht anëtarët e komisionit për datën dhe kohën e mbajtjes së seancave.

3. Seancat organizohen ne baze te ankesave te paraqitura nga palët e dëmtuara/te autorizuarit e palëve.
4. Komisioni i shkallës së dytë shqyrton dhe vendos për ankesat e parashtruara nga palët (nëse ato janë te bazuara) të cilat janë të pa kënaqura me vendimin e komisionit të shkallës së parë.
5. Vendimet ne komisionin e ankesave do te jenë te plotfuqishme nëse për te kane votuar dy nga tre anëtarët e komisionit.
6. Komisioni i shkallës së dytë mund të miratoj, ndryshoj ose anuloj vendimin e komisionit te shkallës së pare si për nga baza juridike po ashtu edhe nga lartësia e dëmit duke dhëne arsyetimin me shkrim.

Neni 6

Kërkesa për rishqyrtim (mjetet e jashtëzakonshme)

1. Kërkesa për rishqyrtim te vendimit te shkalles se dytë i drejtohet Drejtorit te Departamentit te Fondit-Dëmeve i cili do te vlerësoj arsyeshmerin e kërkesës. Nëse drejtori i departamentit te dëmeve vlerëson se kërkesa për rishqyrtim ka baze juridike, atëherë i njëjti kërkon me shkrim nga komisioni i shkalles se dytë rishqyrtimin edhe njëherë te vendimit te komisionit te dytë me qellim te zgjidhjes se kontestit ne procedurë jashtgjygesore.
2. Komisioni i shkalles se dyte brenda afatit prej 3 ditëve do te vendos lidhur me kërkesën e parashtruar sipas pikës 1 te këtij neni.

Neni 7

Puna dhe roli i inxhinierëve ne vlerësimin e dëmeve materiale

1. Pas pranimit dhe evidentimit te demit material nga zyrtari përkatës, inxhinieri vlerësues-terrenit obligohet qe te beje kontrollin vizuel te mjetit motorik te dëmtuar dhe ne përputhje me kriteret teknike, te beje fotografimin e mjetit dhe pjesëve te dëmtuara dhe te hartoj procesverbalin mbi dëmtimin ku duhet te parashihen pjesët qe kane nevojë për ndërrim ose riparim.
2. Procesverbali përpilohet ne tri kopje identike ku, një kopje i dorëzohet palës se dëmtuar, një mbetet ne dosje te demit dhe një tjetër ne arkiv.
3. Secili procesverbal për shkaqe sigurie përmban numrin serik dhe i njëjti pas plotësimit nga inxhinieri duhet te jete i nënshkruar si nga ana e palës se dëmtuar ashtu edhe nga inxhinieri dhe njëjti duhet vulosur me vule zyrtare te BKS.
4. Inxhinieri vlerësues ka për obligim qe me rastin e kontrollimit vizuel te automjetit te dëmtuar te konstatoj ne mënyre te sakte dhe profesionale çdo pjese te dëmtuar te automjetit si pasoj e aksidentit e cila dëshmohet ne baze te fotove te bëra nga inxhinieri i terrenit.
5. Ne rastet e dëmeve te mëdha apo ne rastet kur nuk mund te konstatohen te gjitha pjesët e dëmtuara ne baze te shikimit vizuel, atëherë inxhinieri obligohet qe palën e dëmtuar ta udhëzoj qe automjetin e dëmtuar ta dërgoj ne autoservis te kontraktuar nga Byroja me qellim qe pas